

Prirjet Aktuale ne Reformat e Pensioneve dhe Zbatimi i Tyre ne Vendet qe po hyjne ne BE

*Nje Prezantim ne Takimin jo zyrtar te Ministrave
ne Konferencen Nderkombetare te Punes,
Gjeneva, 10 June 2003*

*Elaine Fultz
Specialiste e Larte ne fushen e Mbrojtjes Sociale
ILO Budapest*



International Labour Office
Maj 2003

Hyrje¹

Çdo i punesuar qe hyn ne tregun e punes shume shpejt perfshihet ne skemen e sigurimeve shoqerore te vendit te tij. Ai/ajo e ben kete edhe pa i njohur risqet qe mbulohen nga keto skema. Pastaj, vite me vone ndodh qe ata qe i shpetojne vdekjes dhe invaliditetit, fillojne te perfitojne pensionin e pleqerise. Pas disa vjetesh, i punesuari apo i mbijetuari terheq pagesat e fundit qe perfiton nga skema. Pergjate 50 vjeteve apo me teper qe mund te shkojne nga fillimi deri ne fund te kesaj historie, i punesuari do te kuptoje qe te ardhurat e tij rriten dhe bien sipas risqeve te paparashikueshme dhe te pallogaritshme. I punesuari do te llogarise qe perqindjet e interesit ne menyre alternative kalojne ulje e ngritje te herepashershme, sipas fluksit te çmimeve, rritjes apo renies ekonomike, shkalles se papunesise, katastrofave natyrore, konflikteve te armatosura, ndryshimeve ne regjimet politike si dhe ndryshimeve ne vleren e parase ne treg. Dhe se fundi, nje pensionist nuk mund ta dije se edhe sa vjet do ta gezoje pensionin.

Nje çeshtje themelore qe duhet te ngrihet ne hartimin e te gjitha skemave te pensioneve eshte se si duhet te shperndahen risqet qe shoqerojne te gjitha keto pasiguri. Kush duhet t'i mbuloje ato dhe si?

Debatet ne lidhje me politiken e pensioneve i kane trajtuar prej kohesh keto çeshtje. Midis modeleve dhe argumenteve te ndryshme te perdorura per t'i mbrojtur ato, mund te shquhen dy kendveshtrime krejt te ndryshme. Sipas kendveshtrimit te pare, i punesuari merr nje pension qe vjen si rezultat i probabilitetit te riskut dhe kontributit te paguar per te nga te gjitha breznite e forcave te punes, nje ndarje qe i krijon mundesine te gjitha te punesuarve te mbrojne vehten deri ne nje mase te caktuar kundrejt humbjes se te ardhurave per shkak te risqeve te ndryshme. Sipas kendveshtrimit te dyte, niveli i mbrojtjes qe i ofrohet çdo te punesuari korrespondon, apo lidhet ngushte me kontributin e tij ne sistemin e pensioneve. Ne kete rast nuk behet fjale per ndarje te riskut apo reduktim te pasigurise.

Principi i ndarjes se riskut zakonisht eshte realizuar nga politikat e pensioneve nepermjet nje statusi ligjor duke i percaktuar perfitimet ne perputhje me te ardhurat e te punesuarve. Ky perfitim eshte tipik ne rastet kur duhet te plotesohet kerkesa per te siguruar nje standard minimal, duke lene te hapur rrugen per dallime ne shperblimet e te talentuarve dhe atyre qe kerkojne me shume. Sisteme te tilla jane klasifikuar si skema te percaktuara nga perfitimet "DB schemes". Ato jane percaktuar ne sensin qe per nje nivel te caktuar te ardhurash te mund te dihet qe me pare sesa do te jete perfitimi per çdo person.

¹ Ne pergatitjen e ketij prezantimi autorja ka pasur reagime te dobishme nga kolege te ILO-s te tille si Friedrich Buttler, Petra Ulshoefer, Emmanuel Reynaud, Krzysztof Hagemeyer, Markus Ruck, dhe Pierre DeLame. Mária Augusztinovics, Agnieszka Chłoń-Domińczak, Edward Gatt, Romas Lazutka, dhe Lauri Leppik i kane dhene ide te dobishme ne analizat e pjeses 1. Markus Ruck ka ndertuar tabelat ne pjesen 1 me ndihmen e specialisteve te pensioneve te vendeve te ndryshme te tille si Ayse Selcuk Gencer, Jiří Král, Cristina Mihes, Plamenka Markova, Cristian Toma, Inta Vanovska, Boris Vavro, Tine Stanovnik, Maria Svorenova, dhe Panayiotis Yiallourous, te cileve ju shprehim falenderimet tona. Çdo gabim qe mund te evidentohet eshte teresisht i autorit, sikurse edhe opinionet dhe pozicionet e shprehura gjate analizës.

Skema te tilla jane nga me te zakonshmet, por jo domosdoshmerisht te administruara nga shteti. Ato jane te financuara ne baze te parimit “pay-as-you-go”. Keshtu qe kontributet e te punesuarve te sotem perdoren per te paguar pensionistet e sotem dhe keta te punesuar, nga ana e tyre, fitojne te drejten te mbeshketen me pensione kur te jene te moshuar.

Ne keto kushte te ndarjes se riskut, perfitimi nuk eshte i lidhur drejtperdrejte me kontributin e paguar, prandaj disa te punesuar do te marrin me teper se sa kontributi (p.sh., nje person qe behet i paafte qe ne fillim te karrieres se tij) dhe disa te tjere do te marrin me pak (p.sh., nje i punesuar beqar qe vdes sapo del ne pension); por ajo qe merr çdo i punesuar eshte siguria e nje perfitimi te parashikuar ne rast paaftesie, pleqerie dhe nje mbrojtje respektive per personat qe jane ne varesi te tij. Nese ndryshimet ekonomike apo demografike krijojne probleme per te garantuar kete siguri, permes nje procesi politik rinegociohet dhe realizohen pershtatjet ne perfitimet, ne perqindjet e kontributeve, apo ne te dyja aspektet, zakonisht perpara lindjes se te drejtes per perfitime. Ne kete menyre, risqet qe shoqerohen me pasiguri ne skemat e ndikuara nga rrethanat e jashtme ndahen midis subjekteve te ndryshme, qe nga shteti, punedhenesi, i punesuari dhe pensionisti.

Sipas modelit apo kendveshtrimit te dyte, nje i punesuar merr nje pension qe reflekton vetem kontributin e tij dhe humbjet apo fitimet nga interesat apo operacione te tjera financiare te akumuluar. Ne kete rast nuk ka formula perfitimi dhe pensioni i paguar nuk merr ne konsiderate risqet e permendura ne modelin e pare. E vetmja gje qe mund te ndikoje eshte jetegjatesia e ndryshme. Ky tip sistemi mban llogari te pervitshme per menyren sesi investohen dhe sesi shkojne akumulimet individuale te personave kontribues. Keto lloj marreveshjesh nga pikpamja e te konceptuarit duken si te thjeshta, por ne fakt kerkojne llogaritje te vazhdueshme dhe te gjithanshme.

Modeli i dyte zakonisht, por jo domosdoshmerisht menaxhohet nga nje numer kompanish private dhe mundesisht konkurruese, te cilat mbajne dhe investojne kontributet e te punesuarve dhe llogarisin ecurine e portofolit te investimeve personale. Ne pleqeri pensionisti duhet te perdori vlerat e portofolit te tij per te marre pagesat vjetore qe i sigurojne atij nje perfitim te rregullte ne forme pensioni per te perballuar jeten. Ky tip i dyte zakonisht njihet si “sistem privat”, “fonde te avancuara”, apo si “llogari kursimesh individuale”. Thelbi i tij eshte mungesa e ndarjes se riskut, nje kalim drejt personalizimit te shumices se risqeve te siperpermendura tek individi qe punon dhe kalimi drejt menaxhimit sipas tregut te portofolit individual dhe sigurimit te pensioneve nga firmat private.

Kundershtite aktuale midis ketyre dy modeleve te pergjithshme jane diskutuar ne vitin 1994 ne nje publikim te Bankes Boterore “*Averting the Old Age Crisis*”, qe fokusonte vemendjen mbi sfidat demografike ne sistemet e pensioneve ne bote, qe vijne per shkak te plakjes se popullsise. Kjo analize sugjeronte qe dallimet ne skemat e pensioneve sipas modelit te pare dhe te dyte mund te shmangin nje krize ne financimin e pensioneve ne kushtet e plakjes se popullsise. Qe nga kjo kohe, keto dallime kane krijuar nje debat te gjere ne gjithe boten mbi politikat e pensioneve, me teper e spikatur ne

Americen Latine, por gjithashtu edhe ne Europe, Afrike, dhe Azine Qendrore. Shumica e ekonomisteve dhe e analisteve kane abandonuar idete baze te studimit dhe thelbi i debatit ka kaluar ne sfera te tjera.² Megjithate akoma vazhdon vemendja ndaj kundershtive midis modeleve qe vihet ne dukje me force nga studimi. Kjo kundershti nuk ka qene asnjehere me dominuese dhe e dukshme sesa ne vendet qe po hyjne ne BE, ku gati gjysma e te cilave kane zbatuar modelin e dyte apo jane duke shqyrtuar legjislacionin per ta bere kete.

Ne kushtet e ekzistences se kesaj kundershtie, ky prezantim do te perpiqet te hedhe drite mbi prirjet ne politiken e pensioneve ne vendet qe po hyjne ne BE. Pjesa I na jep nje panorame te ndryshimeve te ndodhura qe nga mesi i viteve 1990. Aty pershkruhet modifikimi i skemave te sigurimeve shoqerore; futja e mekanizmeve te reja qe eliminojne shperndarjen e riskut dhe transferimin e menaxhimit te kontributeve te te punesuarve tek kompanite tregtare; dhe vendosjen e mekanizmeve te reja nxitese per skemat vullnetare private qe sigurojne pensione suplementare. Pjesa II hedh drite mbi çeshtjet e pensioneve shtese te cilat kane nevoje per me teper vemendje, por qe kane qene ne hije pak a shume nga kundershtite midis modeleve te ndryshme.

ILO ka ndjekur ndryshimet ne skemat e mbrojtjes shoqerore ne rajon pergjate periudhes qe analizohet dhe debatet qe jane zhvilluar kane qene pjese e kesaj eksperience. Me specifikisht ato tregojne per punen e bere nga ILO ne Budapest e mbeshtetur nga qeveria Franceze. Kjo pune perfshin si studimet, ashtu dhe bashkepunimin profesional qe synon ne forcimin e sistemeve te mbrojtjes shoqerore ne vendet qe hyjne ne BE. Studimet e ndermarra si pjese e atij projekti shqyrtojne reformen ne skemat e pensioneve te pleqerise, te invaliditetit, dimensionet gjinore ne reformat e mbrojtjes shoqerore, dhe perpjekjet per ta perdorur sistemin e mbrojtjes shoqerore si mjet ne luften kunder varferise dhe perjashtimit social ne vende te caktuara. Ne analizen e reformes se pensioneve ne vendet e Mesdheut, analizat e meposhtme jane mbeshtetur si nga ILO ashtu dhe nga Komisioni Evropian, shtetet respektive dhe analistet e ketyre shteteve.

I. Eksperienat e fundit ne reformen e pensioneve: nje kendveshtrim rajonal

Qe nga mesi i viteve 1990, vendet qe po hyjne ne BE ne menyra te ndryshme kane kombinuar tre lloje modifikimesh ne skemat e tyre te pensioneve. E para eshte pershtatja e parametrave te sistemeve existuese te sigurimeve shoqerore. E dyta ka te beje me zhvendojen e sigurimeve shoqerore ne drejtim te skemave te kursimeve individuale. E treta, inkurajon opsionet e reja per kursime vullnetare per pleqeri. Kombinimi i veçante i ketyre politikave varion se tepermi nga njeri vend tek tjetri, sikurse dhe menyra e veprimi. Disa vende tani kane vite eksperience ne reformat qe transformojne sistemet e

² Si per shembul, eshte e njohur qe nje devijim ne metoden e financimit te pensioneve nuk ndryshon ndonje gje ne lidhje me mbeshtetjen e te moshuarve, e cila lidhet me GDP korrente ne çdo lloj sistemi pensionesh. Shih seksionin 3.

tyre ne menyre rrenjesore, ndersa te tjerat po i pershtasin sistemet e tyre gradualisht dhe hap pas hapi ne rritje.

Vendet kane bere ndryshime te dukshme ne karakteristikat e skemave te tyre publike te sigurimeve shoqerore si mosha e daljes ne pension, formulat e perfitimeve, trajtimi i kategorive specifike te te punesuarve dhe mbledhjes se kontributeve per pensione. Sikurse shihet nga Tabela 1, nga shumica e vendeve rritjet ne moshat e daljes ne pension jane bere nga 2 ne 3 vjet per meshkujt dhe nga 3 ne 6 vjet per femrat. Shumica e tyre jane rezultat i kompromiseve politike, ku qeverite, duke propozuar fillimisht rritje me te medha, i kane reduktuar ato me pas permes nje procesi negociatash si me sindikatat ashtu dhe me punedhenesit ne disa raste. Ne disa shtete (si Polonia, Sllovenia), propozimet fillestare per te barazuar moshat e daljes ne pension te meshkujve dhe femrave nuk jane pranuar duke ruajtur dallimet mes tyre.

Vendet kane rishikuar ne menyra te ndryshme edhe formulat e perfitimeve. Ne mjaft raste qellimi i ndryshimit ka qene eliminimi i shperndarjes se riskut si nje element i skemave te pensioneve, qe do te thote pensionet te behen me te individualizuara dhe te lidhura me te ardhurat. Hapi me i madh ne kete drejtim u ndermorr nga Letonia dhe Polonia, te cilat i zevendesuan skemat me baze perfitimet me te ashtuquajturat skema ku perfitimet percaktohen nga kontributet. Ne keto raste, niveli i perfitimit per pension pleqerie vendoset teresisht mbi bazen e kontributeve te paguara nga nje person gjate gjithë jetes si dhe jetegjatesise se brezit te tij ne moshen e daljes ne pension.³ Kjo eliminon rishperndarjen e te ardhurave drejt personave me te ardhura te uleta dhe lejon qe perfitimet te ulen apo te ngrihen automatikisht ne pergjigje te ndryshimeve ne jetegjatesi, edhe kur nje individ punon me gjate apo del ne pension me heret. Vende te tjera qe po hyjne ne BE nuk i kane ndryshuar sistemet e tyre te percaktuara nga perfitimet, por per çdo vit pune kane ulur sasine e perqindjes se grumbulluar si periudhe sigurimi per pension (Sllovenia) apo kane reduktuar rishperndarjen e te ardhurave ne drejtim te grupeve me te ardhura te uleta (Hungaria).

Pak vende kane adoptuar ndryshimet ne formulen e perfitimeve qe rrisin rishperndarjen e te ardhurave drejt personave me te ardhura te uleta: Qipro ka rritur pensionet minimale, Republika Ceke ka adoptuar nje formule ku masa e perfitimit perbehet nga dy pjese me synim rishperndarjen drejt personave me te ardhura me te uleta ne te dy pjeset, dhe Sllovenia ka ulur diferencen midis pensioneve te uleta dhe atyre te larta per persona me vite te njejta aktiviteti ekonomik.

Nje pjese e madhe vendesh gjithashtu kane rritur numrin e viteve te punes qe kerkohen per pension, nje ndryshim ky qe forcon lidhjen midis perfitimeve dhe kontributeve gjate gjithë jetes, me synimin qe te inkurajoje pjesemarrjen me te madhe ne tregun formal te punes.⁴

³ Kontributet perfshijne disa interesa te futura mbi bazen e indeksit te pagave.

⁴ Gjithsesi nuk ka ndonje evidence empirike te sakte mbi efektet e kesaj nxitjeje.

Tabele 1. Moshat e daljes ne pension ne vendet qe po hyjne ne BE

| | <i>Ligji referues</i> | <i>Meshkuj</i> | <i>Femra</i> |
|---------------------------|-----------------------|---|--|
| Bullgaria | 2000 | Rritur ne 63 ne 2005 me nga 6 muaj/vit | Rritur ne 60 ne 2009 me nga 6 muaj/vit |
| Qipro | 1995 | 65 (pension i parakohshem ne 63 vjeç) | 65 (63 per ata te lindur para 1/1/1935) |
| Republika Çeke | 1995 | Rritur ne 62 ne 2006 me nga 2 muaj/vit | Rritur nga 57-61 (ne varesi te numrit te femijeve te rritur) me nga 4 muaj/vit |
| Estonia | 1998, ne fuqi 2000 | 63 | Rritur ne 63 ne 2016 me nga 6 muaj/vit |
| Hungaria | 1996 | Rritur ne 62 ne 2002 me nga 1 vit ne 2 vjet | Rritur ne 62 ne 2009 me nga 1 vit ne 2 vjet |
| Letonia | 1998 | Rritur ne 62 ne 2003 me nga 6 muaj/vit | Rritur ne 62 ne 2008 me nga 6 muaj/vit |
| Lituania | 1994, 2000 | Rritur ne 62.5 ne 2003 me nga 6 muaj/vit | Rritur ne 60 ne 2006 me nga 6 muaj/vit |
| Malta | 1987 | 61 | 60 |
| Polonia | 1998 (ne fuqi, 1999) | 65, ku pensionet e parakohshme eleminohen duke filluar nga 2007 ¹⁾ | 60, ku pensionet e parakohshme eleminohen duke filluar nga 2007 ¹⁾ |
| Rumania | 2000 | Rritur ne 65 ne 2015 me nga 1 muaj/ne çdo tremujor | Rritur ne 60 ne 2015 me nga 1 muaj/ne çdo tremujor |
| Republika Sllovaqe | 1988 ²⁾ | 60 | 53-57 (ne varesi te numrit te femijeve te rritur) |
| Sllovenia | 1999 | 63 ³⁾ | 61 |
| Turqia | 1999 | 60 | 58 |

¹⁾ Eleminimi i aplikimit per pensione te parakohshme tek personat e mbrojtur nga skemat e reja si p.sh ata te lindur pas vitit 1948. Megjithate ka edhe perjashtime per nje liste profesionesh te cilat do te specifikohen ne rregulloret e ardhshme. Keto kategori pensionesh do te financohen te ndara nga sistemi i sigurimeve shoqerore.

²⁾ Nje ligj i ri po pergatitet nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Familjes i cili do te rrise gradualisht moshen e daljes ne pension ne 62 vjeç, si per femrat ashtu dhe per meshkujt.

³⁾ Dalja ne pensione te parakohshme para moshes 63 vjeç per meshkujt dhe 61 vjeç per femrat permban gjobitje (ky eshte nje rregull i pergjithshem, por ka edhe perjashtime per grupe te veçanta personash te siguruar). Eshte gjithashtu e mundshme te merren bonuse (p.sh. periudha e sigurimit nje vjeçar te konsiderohet si me e larte) nese periudhat e punesimit jane me te medha sesa 40 vjet per meshkujt apo 38 vjet per femrat.

Midis vendeve ish socialiste, disa qeveri kane standartizuar rregullat e percaktimit te perfitimeve per te punesuarit, duke eliminuar privilegjet per grupe te veçanta te sistemit te meparshem, perfitime per moshën me te uleta te daljes ne pension, per kategori te punesuarish qe qeverite e meparshme i kane konsideruar te nje rendesie strategjike.

Disa shtete i kane eleminuar privilegje te tilla (p.sh. Republika Çeke, Lituania); te tjera i financojne ato te shkeputura nga skema e pergjithshme (p.sh., Sllovenia); dhe ne disa te tjera (p.sh., Estonia, Polonia, Republika Sllovake), çeshtja e privilegjeve ne lidhje me pensionet mbetet ne axhenden e politikës se tyre nacionale.⁵

Perpjekjet per te permiresuar mbledhjen e kontributeve jane fokusuar kryesisht ne adoptimin e te ashtuquajturave sisteme te unifikuara te mbledhjes se kontributeve. Keshtu nje agjenci e vetme mban pergjegjesine per mbledhjen e kontributeve qe financojne skema te ndryshme te sigurimeve shoqerore (p.sh., pensionet, sigurimin e kujdesit shendetesor, sigurimin ne rast papunesie, semundje, aksidenti ne pune), agjenci qe mund te mbledhi edhe taksat mbi te ardhurat. Kjo zgjidhje mund te arrije te detyroje aktivitetet ekonomike ne shkalle te gjere per pagesen e kontributeve dhe i jep kesaj agjencie te drejten e perdorimit te informacionit mbi ndermarrjet, duke perdorur burime shteterore te shumta. Sistemet e unifikuara gjithsesi kane veprim te kufizuar ne mbledhjen e kontributeve te te vetepunesuarve apo te punesuarve ne ekonomine joformale, per te cilet agjencite shteterore nuk kane te dhena te percaktuara. Per me teper, ato i ndajne pergjegjesite ne menyren qe mund te krijojne veshtiresi ne administrimin e pensioneve.⁶ Sistemi i unifikuar i kontributeve eshte vendosur ne Letoni (1996), Slloveni (1996), Estoni (1999), Hungari (1999), dhe Bullgari (2002). Romania ka pershtatur nje ligj qe kerkon mbledhjen ne menyre te unifikuar te kontributeve, i cili do te jete efektiv ne vitin 2004. Ne Republikën Sllovake nje propozim per te unifikuar mbledhjen e kontributeve eshte diskutuar per vite me rradhe.

Bullgaria kohet e fundit ka ndermarre nje tjetër iniciative per te luftuar evazionin kontributiv dhe mosraportimin sa duhet te pagave, duke krijuar kufijte minimale te kontributeve per kategori te caktuara te punesuarish dhe duke kerkuar regjistrim ne institucionet e sigurimeve shoqerore per te gjitha kontratat e punesimit.⁷

Kategoria e dyte e gjere e modifikimeve ka te beje me kalimin ne modelin e dyte te qe debatohet per pensionet, qe lidhet me shkallezimin e sistemit te sigurimeve shoqerore dhe ridrejtimit te nje pjese te kontributeve per pensione ne llogari kursimesh individuale te detyrueshme te menaxhuara sipas tregut. Ky kendveshtrim ndryshon nga ai i adoptuar ne disa vende te Amerikes Latine ku skemat e sigurimeve shoqerore u zevendesuan plotesisht nga llogarite private individuale per pensione (p.sh., Kili). Midis vendeve qe po hyjne ne BE, me teper jane bere perpjekje per te strukturuar nje sistem *miks*, ne te cilin pensionistet e ardhshem do te marrin perfitime permes dy rrugeve, asaj private qe shoqeron ate publike. Ne komponentin privat nuk ka ndarje te riskut apo kursimet individuale te akumuluar deri ne daljen ne pension duhet te perdoren per te blere te

⁵ Ne Republikën Sllovake, preferencat u eleminuan ne 1992 (te cilat do te behen efektive ne 1993), qe u zgjeruan pervit gjate vitit 1990 ne pergjigje te kercenimeve te grevave. Ne vitin 2000, periudhat e punesimit nuk llogariteshin me per qellimet e njohjes se te drejtes per privilegje; gjithesi e drejta per privilegje e bazuar ne periudhat e meparshme te punesimit do te vazhdoje deri ne vitin 2023.

⁶ Per shembull, Fondi i Sigurimit per Pensione ne Hungari mban pergjegjesine per mbajtjen e te dhenave per llogarite mbi kontributet individuale te çdo te punesuari, por nuk ka akses ne informacionin mbi mbledhjen e kontributeve qe realizohet nga autoritetet tatimore.

⁷ It has established 48 such categories. *Pensions International*, "Bulgaria: Funds show only slight growth", March 2003, p. 11.

ardhurat vjetore per pensione pergjate gjithë jetes. Te punesuarve zakonisht ju krijohet mundesia te zgjedhin midis fondeve te menaxhuara nga firmat si dhe e drejta per te transferuar llogarite e tyre nga njera firme tek tjetra. Keto rregullime bejne ne menyre efektive kalimin e riskut nga shoqeria si nje e tere tek individet e punesuar dhe rolin e shtetit e shnderrojne nga sigurues perfitimesh ne rregullator te firmave qe menaxhojne pensionet private.

Reforma te tilla jane adoptuar ne Hungari (1998), Poloni (1999), Bullgari (2000), Letoni (2001), dhe Estoni (2002). Rregullime te ngjashme jane propozuar nga qeverite e reja te Republikes Sllovake dhe te Maltes, nga nje komision i veçante i ngritur per reformat ne mbrojtjen shoqerore. Ne Lituani, qeveria adoptoi nje model hibrid (2002) ne te cilin pjesemarrja ne skemat private individuale eshte vullnetare per te gjithë te punesuarit, por e financuar nga kontributet e terhequra nga skemat publike te sigurimeve shoqerore per personat qe zgjedhin kete opsion. Shtete te tjera kane zhvilluar debate me propozime mbi keto opsione por nuk kane arritur t'i adoptojne ato (Republika Çeke, Rumania, dhe Sllovenia), ndersa te tjera nuk e kane marre seriozisht ne konsiderate kete kendveshtrim (Qipro, Turqi). Configurimi aktual i zgjedhjeve ne politiken sociale permblidhet ne Tabelen 2.

Tabela 2. Situata e Privatizimit te Pensioneve ne vendet qe hyjne ne BE

| <i>Vende me llogari kursimesh te detyrueshme, te menaxhuara sipas tregut</i> | <i>Vende pa skema te tilla</i> |
|--|-----------------------------------|
| Hungari (1998) | Qipro |
| Poloni (1999) | Republika Çeke |
| Letonia (2001) | Lituania ⁽¹⁾ |
| Estonia (2002) | Malta ⁽²⁾ |
| Bullgaria (2002) | Rumania |
| | Republika Sllovake ⁽³⁾ |
| | Sllovenia |
| | Turqia |

⁽¹⁾ Kollona e dyte vullnetare financohet nga kontributet e terhequra nga sistemet publike te pensioneve.

⁽²⁾ Privatizim i pjesshem i propozuar nga komisionet e veçanta te reformave ne mbrojtjen shoqerore.

⁽³⁾ Privatizim i pjesshem qe po zhvillohet nga qeverite e reja.

Qe ky ndryshim ne politiken sociale te merret ne konsiderate nje rol te rendesishem luajne kostot financiare tranzitore. Keto kosto rezultojne nga nevoja e dyfishte per te vendosur llogarite e kursimeve individuale dhe ne te njejten kohe vazhdojne te respektohen detyrimet per perfitime nga skemat ekzistuese pay-as-you-go. Keto kerkesa do te vene ne dukje barren fiskale per dekada te tera qe varion nga 0.5 ne 2.5 perqind te PPB ne vit. Mbulimi i ketyre kostove perfshin probleme specifike ne vendet qe po hyjne ne BE, perderisa shumica jane duke vepruar ne situata te veshtira politike ku nuk mund te

bejne rritjet e kontributeve. Keto sforcime politike rrjedhin nga perqindjet aktuale te kontributeve, te cilat sipas standarteve nderkombetare konsiderohen te larta. (Shih Tabelen 3.)

**Tabela 3. Perqindjet e kontributeve per pension ne vendet aplikante per BE 2002
(si perqindje e pagave mbi te cilat llogariten kontributet)**

| | <i>Punedhnesi</i> | <i>I Punesuari</i> | <i>Shteti</i> | <i>Totali</i> |
|--------------------|---------------------|--------------------|---------------------|-----------------------------------|
| Bullgaria | 21.75 ¹⁾ | 7.25 ¹⁾ | | 29 ¹⁾ |
| Qipro | 6.3 | 6.3 | 4 | 16.6 ²⁾ |
| Republika Çeke | 19.5 | 6.5 | | 26 |
| Estonia | 20 | 2 ³⁾ | | 22 ⁴⁾ |
| Hungaria | 18 | 8 | | 26 ⁵⁾ |
| Letonia | -- | -- | 27.10 ⁶⁾ | 30.86 ⁷⁾ |
| Lituania | 22.5 | 2.5 | | 25 |
| Malta | 10 | 10 | 10 | 30 |
| Polonia | 16.26 | 16.26 | | 32.52 |
| Rumania | 23 ⁸⁾ | 12 | | Varet nga perqindja e punedhnesit |
| Republika Sllovake | 21.6 | 6.4 | | 28 |
| Sllovenia | 8.85 | 15.5 | | 24.35 |
| Turqia | 11-13 ⁹⁾ | 9 | | 20-22 |

¹⁾ Keto perqindje aplikohen per kushte pune normale dhe per persona te lindur para 1 Janarit, 1960. Per persona te lindur pas kesaj date, perqindjet e kontributeve jane: 20.25% (punedhnesit), 6.75% (te punesuarit), 27% (totali). Per pune te renda dhe shume te renda, perqindjet e kontributeve jane: (i) per personat e lindur para 1 Janarit, 1960: 24.75% (punedhnesit), 7.25% (te punesuarit), 32% (totali); (ii) per personat e lindur pas 1 Janarit, 1960: 23.25% (punedhnesit), 6.75% (te punesuarit), 30% (totali).

²⁾ Keta tregues mbulojne te gjitha risqet sociale. Ligjerisht kontributet nuk mund te transferohen midis perfitimeve afatshkurtera dhe afatgjata, me perjashtim te perfitimeve per papunesi, per te cilat eshte alokuar 0.996% (6% e 16.6%).

³⁾ 2% e kontributeve te te punesuarve per kolonen e dyte me financim kapital eshte e detyrueshme per personat qe sapo hyjne ne tregun e punes (personat e lindur pas 1983) dhe eshte e lire per forcat e punes aktuale.

⁴⁾ Per personat qe nuk kane hyre ne kolonen e dyte, perqindja totale e kontributeve per pensione eshte 20%.

⁵⁾ Ne 2003, ne totalin prej 26.5 perqind, 18 perqind i paguan punedhnesi dhe 8.5 perqind i punesuari.

⁶⁾ Kolona e pare e pensioneve mbulohet nga buxheti i shtetit per sigurimet shoqerore, siç jane pensionet e pleqerise te dhena para reformes se vitit 1996.

⁷⁾ Perfshin 3.76% per paaftesi (e pashperndare midis punedhnesit dhe punemarresit). Ne vitin 2003, perqindja e pergjithshme e kontributeve te sigurimeve shoqerore eshte 33.09%. Ajo mbulon si perfitimet afatshkurtera, ashtu edhe ato afatgjata. 24.09% paguhet nga punedhnesit (ku perfshihet 0.09% per aksidente ne pune) dhe 9% nga te punesuarit.

⁸⁾ 23% kontribut per pune ne kushte normale, per pune te renda dhe shume te renda perqindjet jane respektivisht 28% dhe 33%.

⁹⁾ Varion bazuar ne sektorin e punes (me te larta per pune te renda).

Duke pasur parasysh keto situata te veshtira, shumica e vendeve qe kane zgjedhur kete model i perballojne kostot financiare tranzitore duke rritur borxhet publike, apo nga

te ashtuquajturat financime te brendshme p.sh., duke shkurtuar perfitimet nga pensionet publike.⁸ Disa te tjera, per te perballuar kostot e larta financiare tranzitore kane zgjedhur te realizojne kolonen e pensioneve private gradualisht, me disa faza. (Shih Tabelen 4.)

Tabela 4. Perqindjet e kontributeve per pensione ne vendet qe po hyjne ne BE me kolonat e detyrueshme private te pensioneve, 2002

| Vendi | Totali | | | PAYGO (Kolona 1) | | | Me financim kapital (Kolona 2) |
|-----------|--------------|--------------------|--------------------|---------------------|---------------------|--------------------|-----------------------------------|
| | <i>Shuma</i> | <i>Punedhenesi</i> | <i>I punesuari</i> | <i>Shuma</i> | <i>punedhenesi</i> | <i>I punesuari</i> | |
| Bullgaria | 29.00 | 21.75 | 7.25 | 27.00 ¹⁾ | 20.25 | 6.75 | 2.00 ¹⁾ |
| Estonia | 22.00 | 20.00 | 2.00 ²⁾ | 16.00 ³⁾ | 16.00 ³⁾ | | 4.00 + 2.00 ²⁾ |
| Hungaria | 26.00 | 18.00 | 8.00 | 20.00 | 18.00 | 2.00 | 6.00 ⁴⁾ |
| Letonia | 30.86 | -- | -- | -- | -- | -- | 2.00 ⁵⁾ |
| Polonia | 32.52 | 16.26 | 16.26 | 25.22 | 16.26 | 8.84 | 7.30 |

¹⁾ 2% kontribut per kolonen e dyte eshte i detyrueshem per personat e lindur ne 1 Janar, 1960 apo me pas. Personat e lindur para kesaj date nuk marrin pjese ne kolonen me financim kapital dhe kontribuojne 29% per kolonen e pare. Shperndarja e kontributeve midis dy kolonave percaktohet çdo vit ne ligjin per buxhetin vjetor.

²⁾ Nje kontribut shtese (2%) eshte i detyrueshem per personat qe sapo hyjne ne tregun e punes (personat e lindur ne vitin 1983 apo me vone) dhe i lire per forcat ekzistuese te punes.

³⁾ Per personat qe nuk kane hyre ne kolonen e dyte, perqindja e kontributeve per kolonen e pare te pensioneve eshte 20%. Per personat qe kane hyre ne kolonen e dyte, 4 perqind e pikeve te taksave sociale te punedhenesit kanalizohet ne skemat me financim kapital.

⁴⁾ Ne vitin 2003 perqindja e kontributeve do te rritet ne 6 deri 7%. Perqindja totale e rritur ne 26.5% perfshin 18% per punedhenesit dhe 8.5% per te punesuarit.

⁵⁾ Kontributet per kolonen e dyte jane parashikuar te rriten ne 4% ne vitin 2007, ne 8% ne vitin 2008, ne 9% ne vitin 2009 dhe ne 10% ne vitin 2010.

Studimet e ILO-s ne Hungari dhe Poloni, ne keto vende te rajonit qe njihen si pioniere te ketij modeli, nxjerrin ne dukje parakushte te metejshme per suksesin e ketyre reformave.⁹ Pervoja e ketyre shteteve mund te jete me perfitime te medha per shtete te tjera qe po planifikojne, zbatojne apo diskutojne ndryshime te tilla. Se pari, dhe ndoshta me e rendesishme eshte qe, kjo pervoje tregon per nevojen e kontrollit te kostove administrative te skemave private, te cilat kane ndikuar ne humbje te kursimeve te personave te siguruar ne skemat me menaxhim privat, qe do te thote se masa e kthimit

⁸ Huate ne rritje jane problematike per shume vende per shkak te deficiteve te larta existuese te financave publike. Per me teper, ne kontekstin e Traktatit te Maastrichtit (protokollet per Nenin 109), deficitet vjetore ne buxhetet (duke perfshire mbrojtjen shoqerore) normalisht nuk mund t'i kalojne tre perqind te PPB dhe borxhet e akumuluar me pak sesa 60 perqind e PPB.

⁹ Elaine Fultz, redaktore, *Pension Reform in Central and Eastern Europe, Volume 1, Restructuring with Privatization: Case Studies of Hungary and Poland*, Budapest: ILO CEET, 2002.

real te ketyre kursimeve rezulton me kahje negative per te dy shtetet.¹⁰ Se dyti, llogarite individuale kerkojne nje mbajtje dhe rregjistrim te shumave ekzakte te parave per çdo kontribut mujor te bere per çdo te punesuar. Kjo sigurisht eshte perseri nje kosto dhe nga pikpamja administrative perben nje sfide qe as shteti nuk ka qene ne gjendje ta permbushi plotesisht. Se treti, sistemet e llogarive individuale synojne te sigurojne qe perfitimet per pleqeri te bazohen ne principe krejt te ndryshme nga perfitimet nga skemat e tjera. Llogarite e reja duhet qe ne te gjitha rastet te integrohen me perftimet e tjera - pensionet e invaliditetit dhe ato familjare – ne menyre qe te shmanget kalimi i koston se pensioneve te pleqerise tek keto programe te tjera dhe te ndodhin humbje te paparashikuara dhe te papritura. Se fundi, eshte e rendesishme te planifikohen qe me pare te gjitha tiparet e nje sistemi dhe te sigurohet edukimi i vertete i publikut me qellim qe punetoret qe perballen njehere me zgjedhjen per tu futur ne sistemin miks te mund ta bejne keto zgjedhje mbi bazen e njohjes se te gjitha rregullave mbi te cilat do te veproje sistemi i ri i kursimeve individuale. Ne te dy vendet, kerkesat e medha per rritjen e llogarive te reja individuale dhe menaxhimin e tyre, kane bere qe qeverite te lene pas dore disa nga keto çeshtje.

Planet per pensionet vullnetare suplementare perbejne nje tjetër grup te gjere ndryshimesh. Keto synojne te inkurajojne punetoret te luajne nje rol me te madh ne financimin per pleqerine e tyre dhe keshtu te krijojne burime shtese per pension ne kushtet e plakjes se popullsise.¹¹ Entuziazmi per kursimet per pensionet vullnetare ka qene i madh ne vendet ish socialiste. Ligji i pare u aprovua ne Hungari dhe ne Republikën Çeke (1994) dhe pastaj ne Republikën Sllovake (1996). Qe nga ajo kohe, pothuajse te gjithë ndoqen keto gjurme. (Shih Tabelen 5.) Per me teper, Turqia po ndjek zhvillimin e skemave vullnetare si nje nga hapat kryesore te metejshme, ndersa ne Malte planet vullnetare suplementare jane propozuar si pjese e sistemit trikolonesh te pensioneve. Ne Qipro, kursimet vullnetare jane te perhapura gjeresisht permes fondeve te kursimeve, te cilat sigurojne nje shume te menjehershme pagese me daljen ne pension.

Pervojat e meparshme tregojne padyshim se ne ngritjen e skemave vullnetare sfidat e medha qendrojne ne terheqjen e punetoreve te rinj dhe te atyre me te ardhura te uleta, duke i inkurajuar ata te kursejne shuma te konsiderueshme, dhe duke i nxitur punedhenesit te kontribuojne per te plotesuar keto pensione. Zhvillimet e ngadalta ekonomike kane vepruar negativisht ne shtimin e skemave vullnetare ne disa vende si (Polonia dhe Republika Sllovake), ndersa ne te tjerat popullsia e vogel dhe tregu financiar i pazhvilluar i kane dekurajuar kompanite private per te krijuar fonde te tilla (p.sh., Lituania). Ne disa shtete, nxitjet e kursimeve vullnetare nepermjet sistemit te taksave kane qene efektive, megjithese te kushtueshme ne inkurajimin e zhvillimit te tyre.

¹⁰ Ne Hungary, ne 1998-2000, per industrine si nje e tere, perqindja e kthimit e llogaritur keshtu varionte mesatarisht ne -4.1 perqind (7.1 perqind rritje kundrejt inflacionit mesatar prej 11.2 perqind). Ne Poloni, perqindja neto e kthimit per inflacionin per te gjitha firmat ne industri varionte nga me e larta -3 perqind tek me e uleta -14 perqind. Keto perqindje u llogariten per periudhen Shtator 1999 deri ne Qershor 2001.

¹¹ Meqenese ato financohen nga kontribute shtese, keto rregullime nuk permbajne kosto financiare tranzitore. Sikurse eshte permendur me pare, reforma e ndermarre ne Lituani ne 2002 eshte nje perjashtim. Ne keto rast pjesemarrja eshte vullnetare, ndersa financimi realizohet nga te ardhurat nga sistemet e pensioneve publike per ata qe hynin ne skeme.

Ne vendet qe po hyjne ne BE, skemat e ndryshme vullnetare jane konceptuar si llogari kusimesh individuale, fonde te mbeshtetjes reciproke dhe pensione profesionale. Kostot e larta administrative te mbajtjes se llogarive individuale i kane drejtuar disa qeveri te nxisin skemat e punedhenesve, ku keta te fundit kontribuojne dhe mbikqyrin zbatimin e tyre (p.sh., Republika Çeke dhe Rumania). Ne mjaft vende rregullime te tilla kane treguar per menaxhim me te mire dhe perfitime me te medha, ne krahasim me skemat e kursimeve individuale, ku punedhenesit nuk kane ndonje rol. Per me teper, skema te tilla shtohen ne morine e elementeve qe mund te behen pjese e marreveshjeve kolektive dhe ne kete menyre mund te ndihmojne ne permiresimin e perfitimeve sociale dhe zgjerimin e mbrojtjes shoqerore. Jo vetem kaq, por pensionet mbi baza profesionale shpesh karakterizohen nga format e menaxhimit qe lejojne si punedhenesit ashtu dhe te punesuarit te bashkepunojne per t'i drejtuar ato se bashku.

Tabela 5. Ligjet qe Autorizojne Fondet e Pensioneve Vullnetare ne vendet qe po hyjne ne BE

| <i>Vendi</i> | <i>Viti i fillimit</i> |
|--------------------|------------------------|
| Bullgaria | 1996 |
| Qipro | -- 1) |
| Republika Çeke | 1994 |
| Estonia | 1998 |
| Hungaria | 1994 |
| Letonia | 1998 |
| Lituania | 2000 ²⁾ |
| Malta | -- 3) |
| Polonia | 1999 |
| Rumania | -- 4) |
| Sllovenia | 2000 ⁵⁾ |
| Republika Sllovake | 1996 |
| Turqia | 2001 |

1) Shtirija e skemave private suplementare sigurohet nga fondet e kursimeve te cilat japin pagesa fikse. Nje ligj mbi rregullat per fondet e kursimeve hyri ne ffuqi me 1981. Per me teper, Qipro ka skema suplemenare te detyrueshme per te punesuarit ne sektorin publik dhe per ata ne kompanite gjysempublike.

2) Gjithsesi, deri tani nuk jane vendosur fonde pensionesh ne Lituani. Disa pensione sigurohen nga kompanite e sigurimit te jetes dhe ende nuk jane te rregulluara me ligjin e ri.

3) Pensionet profesionale u mbyllen ne 1979. Po shqyrtohet nje propozim per nje sistem tri-kolonesh, ku perfshiheshin skemat suplementare vullnetare.

4) Pensionet profesionale te propozuara nga qeveria dhe qe aktualisht jane duke u marre ne konsiderate.

5) Ligji mbi kolonen e dyte te pensioneve hyri ne fuqi me 1992, por pa mbeshtetje nga sistemi i taksave. Ligji i vitit 2000 i cili siguronte mbeshtetjen nga taksat per skemat e kursimeve per pensione pati perparesi mbi ligjin e meparshem. Per nje numer te vogel punetoresh (ata qe punonin ne industrine e rende), kontributet e punedhenesit per skemat suplementare te pensioneve jane te detyrueshme.

Burimi: CEE countries: International Network of Pension Regulators and Supervisors, "Regulation of Pension Fund Investment in CEE Countries"

12 Dhjetor 2002. Informacion per vendet e Mesdheut nga Ministrite e Punes respektive.

Duke ndjekur shperndarjen e ketyre tre tipeve te skemave ne keto vende, mund te dallohen dy strategji te pergjithshme qe u korrespondojne drejtperdrejte çeshtjeve te debateve te permendura me siper. Nje grup vendesh po skicojne skemat publike, pay-as-you-go dhe krahas tyre, po vendosin skemat e kursimeve individuale te menaxhuara privatisht (Hungaria, Polonia, Bullgaria, Letonia, Estonia). Nje grup i dyte, ku perfshihet Republika Çeke, Sllovenia, Turqia dhe Rumania, jane duke kombinuar pershtatjet ne sistemet e tyre te pensioneve publike me zhvillimin e skemave suplementare vullnetare te pensioneve te pleqerise.¹² Shkurtimisht --

¹² The remaining countries -- Cyprus, Lithuania, and Malta -- do not fall neatly into either group. As previously explained, Cyprus continues to rely on its public pension scheme as the primary instrument for

- Republika Çeke ne vitin 1994 aprovoi nje ligj ku autorizoheshin fondet vullnetare private te pensioneve dhe pergjate viteve 1990 kaloi nje seri prej 13 modifikimesh te skemave te pensioneve publike. Midis tyre, nje ligj i vitit 1995 rriti moshen e daljes ne pension pleqerise, u vendos nje formule e re per llogaritjen e perfitimeve dhe u rrit numri i viteve te punes qe llogariten si peridudhe sigurimi per pensionet. Aktualisht ne Çeki gjysma e forcave te punes marrin pjese ne skemat vullnetare suplementare.
- Sllovenia zbatoi ndryshime te medha ne vitin 1999 qe rriten moshen e daljes ne pension pleqerise per femrat, u krijua nje sistem i ri shperblimi per pensionet qe kerkoheshin pertej moshes ligjore te daljes ne pension dhe nje sistemi i ri i reduktimeve per pensionet e parakohshme, u reduktua shkalla e zevendesimit te pensionit ne raport me pagen, u rrit karakteri rishperndares dhe u ngarkuan autoritetet pergjegjese si dhe u rriten nxitjet nepermjet taksave per nje zgjerim me te madh te skemave te kursimeve private. Sot fondet e reja private mbulojne nje ne kater punetore Sllovene.
- Turqia, ne vitin 1999, zbatoi nje reforme qe rriti moshen e daljes ne pension, qe frenonte punesimin e parregjistruar dhe rriste tavanin e pagave mbi te cilat paguhen kontributet. Ne vitin 2001 u hap ligjerisht rruga per pensionet suplementare private. Turqia eshte duke planifikuar ndryshime te metejshme per te forcuar drejtimin e skemave publike, veçanerisht ne lidhje me mbledhjen e kontributeve.
- Rumania per disa vjet ka diskutuar mbi privatizimin ne shkalle te gjere te skemave te pensioneve publike, por akoma nuk i ka aprovuar ato. Ne vitin 2000 qeveria beri ndryshime ne skemat publike qe perfshinin nje rritje te moshes se daljes ne pension pleqerise. Aktualisht ajo po zhvillon legjislacionin qe do te hape rrugen per pensionet suplementare profesionale mbi baza vullnetare.

Duhet te veme ne dukje se tre nga keto vende – Republika Çeke, Rumania dhe Sllovenia – kane debatuar fuqishem mbi privatizimin e skemave te tyre te pensioneve publike, krahas ndryshimeve te adoptuara nga vendet e grupit te pare. Ne çdo rast, vendimet e qeverive per te lene menjane kete mundesi jane bazuar pjeserisht ne njohjen e koston se larte financiare tranzitore te ketij kalimi nga skemat pay-as-you-go ne fondet e pensioneve me financim kapital. Ne Republikën Çeke dhe Slloveni, qendrimi i qeverive ka qene i influencuar edhe nga kundershimet e forta te sindikatave, te cilat e perceptojne privatizimin e pensioneve si shkaterrim te sistemit publik te sigurimeve shoqerore. Per me teper, meqenese te dy vendet kane relativisht nivele te uleta te deficitit te jashtem, ato mund te kene qene me pak te hapura ndaj influences se organizatave financiare nderkombetare qe favorizojne strategjite per privatizim.¹³

Per ta permbledhur, ne te vertete te gjitha vendet qe po hyjne ne BE jane duke modifikuar sistemet e tyre te pensioneve publike. Disa ndryshime (rritja e moshes se daljes ne pension) jane te njejta per vendet e rajonit, ndersa te tjerat i çojne skemat ne drejtime te ndryshme (rishikimi i formuleve se perfitimit per te rritur apo zvogeluar shperndarjen e riskut). Nje numer teper i vogel (pese vende) jane duke i zhvendosur

retirement protection; it has not adopted either the second model or private pension schemes for voluntary individual savings. Lithuania adopted a hybrid approach in which the second tier is voluntary but financed from public pension contributions for those who join. In Malta a three tier system has been proposed but met with opposition from trade unions, and no consensus has been reached.

¹³ Katharina Müller, "Between State and Market: Czech and Slovene Pension Reform in Comparison" in Elaine Fultz, editor, Pension Reform in Central and Eastern Europe, vol. 2., Restructuring of Public Pension Schemes: Case Studies of the Czech Republic and Slovenia, Budapest: ILO, 2002.

gradualisht kontributet e sistemeve te pensioneve publike ne llogarite te reja individuale te menaxhuara sipas tregut. Nje pjese e madhe vendesh po inkurajojne punetoret dhe punedhenesit e tyre te kursejne me teper per pleqeri mbi baza vullnetare.

II. Duke veshtruar drejt se ardhmes

Ndersa te gjitha vendet qe po hyjne ne BE kane bere ndryshime te dukshme ne sistemet e tyre te pensioneve, keto sisteme vazhdojne te perballojne sfida te verteta financiare, ekonomike, demografike dhe administrative. Gjetja e konsensusit mbi masat e dobishme qe i drejtohen ketyre sfidave perben nje nga detyrat kryesore qe po perballojne qeverite e ketyre vendeve. Perqendrimi i debateve mbi kendveshtrimet per skemat publike apo per skemat private, ne nje fare kuptimi, ka penguar progresin, duke lene menjane disa ceshtje te rendesishme dhe duke shtremberuar te tjerat.

Se pari, dhe ceshtja me kryesore qe ka nevojte per vemendje me te madhe eshte menaxhimi i skemave dhe, ne vecanti mbledhja e kontributeve per pensione. Gjate viteve 1990, si rezultat i rritjes se vetepunesimit dhe i ekonomise joformale, shumica e vendeve qe po hyjne ne BE kane pesuar humbje te numrit te kontribuesve. Ne disa nga vendet ish socialiste keto humbje ishin dramatike, ne rreth 25 perqind a me shume te numrit te kontribuesve te meparshem.¹⁴ Ne te njejten kohe, eshte perhapur gjeresisht edhe raportimi i pagave nen nivelin e tyre te vertete. Per rrjedhoje, renia ne te ardhurat po ushtron presion te madh mbi skemat kombetare te pensioneve, duke kerkuar subvencione nga shteti, te cilat perbejne nje barre te rende fiskale, apo duke reduktuar masen e perfitimeve qe krijon veshtiresi per te moshuarit per te perballuar jetesen.¹⁵ Zgjidhja kryesore qe eshte bere, sikurse pershkruhet me sipër, eshte unifikimi i mbledhjes se kontributeve brendaperbrenda shtetit, ne me te shumten e rasteve nen autoritetet tatimore. Ky kendveshtrim, i cili mund te ktheje rrjedhen e formave te ndryshme te evazionit, duhet te plotesohet me strategji te reja, qe te mund te perfshijne ne mbrojtjen shoqerore firmat dhe te punesuarit ne ekonomine gri apo te zeze, transakcionet e te cilave nuk pasqyrohen ne te dhenat e agjencive shteterore.¹⁶ Per me teper, ne disa vende kerkohej nje veprim i niveleve te larta per te detyruar pagesen e kontributeve nga organizatat gjysme-publike. Per aq kohe sa asnje skeme pensionesh, e cfardo lloj modeli, nuk mund te jete e suksesshme pa te ardhura qe te siguroje perfitime, kjo perben nje ceshtje me rendesi te madhe per te gjitha.¹⁷

Nje aspekt i dyte jane pensionet e invaliditetit. Ne shumicen e vendeve qe po hyjne ne BE problemet e skemave te pensioneve te invaliditetit kane njohur me pak

¹⁴ R. Palacios, M. Rutkowski, and X. Yu, *Pension Reform in Transition Economies*, World Bank, Washington, D.C., 1999.

¹⁵ Kjo e fundit ka ardhur ne me te shumten e rasteve si rezultat i deshtimit te indeksimit adekuat te perfitimeve.

¹⁶ Per shembull, kontributet mund te mblidhen si nje takse mbi produktet apo te ardhurat e industrive te ndryshme, apo mund te bazohen ne vleresimin e punes se nevojitur per lloje te ndryshme veprimtarish (p.sh., ndertimi).

¹⁷ Kjo nevojte per nje vemendje me te madhe per kontributet u nenvizua ne konferencen mbi pensionet ne Ljubljane (Nentor 2002), te sponsorizuar nga ILO ne bashkepunim me Qeverine e Frances, Keshillin e Evropes dhe Iniciativen per Kohezionin Social te Paktit te Stabilitetit per Evropen Juglindore. Konkluzionet e saj theksojne si nevojten me urgjente ne rajon permiresime ne menaxhimin e skemave dhe sigurojne nje kuader per te perqendruar me teper vemendjen dhe per te rritur profesionalizmin ne mbledhjen e kontributeve.

mbeshtetje publike krahasuar me skemat e pensioneve te pleqerise dhe reformat legjislativ qe jane bere kane qene me te kufizuara ne permbajtje dhe, ne me te shumten e rasteve, kane qene si nje shtojce per te zgjeruar legjislacionin mbi pensionet e pleqerise. Ne pergjithesi, reformat mbi riskun e paaftesise ne vitet 1990 synonin t'u jenin forme te caktuar kushteve te perfitimit dhe t'i perqendronin skemat veçanerisht ne funksionin e tyre kryesor te zevendesimit te te ardhurave te humbura. Nga studimet tona rezulton se keto reforma kane reduktuar shpenzimet e skemave dhe kane rritur, ndonese me pak efekt, perqindjet e angazhimit ne pune te personave ne pension invaliditeti.¹⁸ Perkundrazi, ne shumicen e vendeve keto perqindje jane ulur. Kjo situatë do te behet me kritike me rritjen e popullsisë se plakur dhe me rritjen e numrit te punetoreve ne moshë te larta me probleme te lehta, apo relativisht te lehta shendetesore, qe kerkojne pensione invaliditeti. Qe t'u paraprihet ketyre sfidave, do te ishte e nevojshme integrimi i skemave te pensioneve me rehabilitimin profesional dhe mjete te tjera qe mundesojne dhe inkurajojne keta punetore te qendrojne apo te rifuten ne forcat e punes.¹⁹

Po te shkohet me tej, nje aspekt i trete i reformave te pensioneve eshte dimensionin gjinor. Ne shume nga vendet qe po hyjne ne BE, reformat e viteve 1990 kane pasur nje ndikim gjinor anesor, ne pergjithesi me disavantazhet e femrave ne raport me meshkujt.²⁰ Duke u ruajtur nje hendek i vazhdueshem ne pagat midis meshkujve e femrave, femrat me teper kane humbur nga reformat, ku perfitimet kryesore jane lidhur me ngushte me pagat e secilit punetor dhe kontributet – p.sh., skemat me perfitime te bazuara ne kontributet dhe llogarite individuale te menaxhuara sipas tregut. Studimet po ashtu tregojne per efekt veçanerisht negativ te kombinimit (i) te eliminimit te rishperndarjes ne formulën e llogaritjes se pensionit me (ii) vazhdimin e mundesise per pensione te parakohshme duke reduktuar perfitimet, sikurse ka ndodhur ne Poloni. Ky kombinim do te reduktojne ne thelb nivelet e pensioneve te femrave, ne krahasim me meshkujt dhe do te rrisë riskun e kalimit te tyre ne varferi gjate pleqerise. Ne menyre ironike, po t'i drejtohem moshave me te uleta te daljes ne pension te femrave ne vendet ish socialiste, reformat per barazimin e tyre me meshkujt nenkuptojne nje rritje me te madhe te moshes se femrave ne krahasim me ate te meshkujve. Ndoshta, ajo qe eshte me e rendesishme ne studimet tona eshte se, perdorimi i treguesve te ndryshem te tabelave te jetegjatesise per meshkujt dhe femrat, ne konvertimin e llogarive individuale ne te ardhura vjetore per pension pleqerise, permban efekte qe demtojne femrat duke i bere ato me te ekspozuara ndaj varferise ne pleqeri.

Duke analizuar reformat e viteve 1990 ne shumicen e vendeve, arrihet ne perfundimin qe analiza gjinore duhet te behet pjese e analizave per çdo propozim per reforma. Kjo konsiderate do t'i modelonte reformat ne nje kendveshtrim te ri, duke

¹⁸ E. Fultz and M. Ruck, editors, *Reforming Worker Protections: Disability Pensions in Transformation*, Budapest: ILO, 2002.

¹⁹ Masa te tjera perfshijne politiken e taksave dhe sigurimin e teknologjive ndihmese qe mundesojne te punojne disa njerez me paaftesi.

²⁰ E. Fultz, M. Ruck, and S. Steinhilber, editors, *The Gender Dimensions of Social Security Reform in Central and Eastern Europe: Case Studies of the Czech Republic, Hungary, and Poland*, in draft, ILO CEET: Budapest, 2003.

zbuluar pasojat e paparashikuara te zgjedhjeve te veçanta politike dhe duke fuqizuar organizatat qe kane interes ne çeshtjet e barazise gjinore per te marre pjese ne menyre me efektive ne parashtrimin e reformes.

Ndersa keto çeshtje kane qendruar disi ne hije ne disa vende per shkak te debateve mbi modelet kryesore te skemave, ka nje fushe ku ato kane deformuar te kuptuarit mirekuptimin e publikut. Kjo eshte çeshtja e plakjes se popullsise. Sikurse reflektohet ne titullin e punimit te njohur te Bankes Boterore “*Averting the Old Age Crisis*”, (Menjanimi i Krizes se Moshes se Vjeter) shkallezimi gradual i skemave kombetare te pensioneve dhe mbeshtetja ne kursimet individuale fillimisht luajten rolin si nje mjet per te shmangur problemet financiare qe po ndeshnin te moshuarit nga skemat e pensioneve pay-as-you-go, p.sh., rritja e defiçitit qe rezultonte nga nje renie progresive ne raportin e kontribuesve ndaj perfituesve. Aty argumentohet se skemat e kursimeve individuale mund ta shmangnin kete krize financiare, duke mundesuar çdo punetor te kursente per pleqerine e tij. Nderkohe qe, duke ju drejtuar intuitivisht ketyre argumenteve ato jane lene menjane nga te gjithë pasuesit ekonomiste dhe analiste, bazuar ne faktet qe plakja e popullsise ndikon si skemat pay-as-you-go ashtu dhe ato me financim kapital. Ne kuptimin makroekonomik, te dy tipet e skemave perbejne mekanizma per shperndarjen e Prodhimit te Pergjithshem te Brendshem aktual midis te atyre qe punojne dhe pensionisteve; dhe cilado skeme qe te adoptohet, gjenerata qe punon duhet te mbeshtese te moshuarit, si permes ndarjes se nje pjese te vlerave qe ajo prodhon, ashtu dhe nepermjet kontributeve te drejtperdrejta per te blere vlera ne llogarite e tyre individuale. Duke pasur parasysh kete realitet, kalimi nga skemat pay-as-you-go tek fondet e avancuara nuk menjanon sfiden e plakjes. Kjo sfide duhet te perballohet me mjete te tjera.

Ajo qe eshte kryesore ne masat qe duhen marre ne konsiderate per te perballuar plakjen e popullsise jane politikat makroekonomike dhe ato te tregut te punes, te cilat rrisin punesimin ne ekonomi dhe ne kete menyre kreuojne hapësira edhe per te punesuar te moshuarit. Ne te njejten kohe, reformat e pensioneve jane te nevojshme per te motivuar dhe mundesuar personat me mosha te larta te qendrojne ne forcat e punes ose te dalin gradualisht ne pension. Gjithashtu eshte e nevojshme te merren ne konsiderate masa reformash me te gjera. Politika me liberale per emigracionin mund te rrisin perqindjet e forcave produktive ne popullsine e çdo vendi.²¹ Po ashtu masat qe nxisin produktivitetin ekonomik kombetar mund te rrisin madhesine e tortes ekonomike nga e cila mund te perfitojne edhe personat e moshuar. Masa te tilla do ta bejne me te lehte mbeshtetjen per te moshuarit per çfaredolloj skeme pensionesh.

Duhet te theksohet se keto konkluzione kryesore kane dale nga mjaft konferenca te koheve te fundit qe jane fokusuar mbi plakjen, ku perfshihen: Komiteti mbi Mbrojtjen Shoqerore ne Konferencen Nderkombetare te Punes (Gjeneva, Qershor 2001); Samiti Boteror mbi Plakjen (Madrid, Prill 2002); Konferenca e rradhes e Ministrave mbi Plakjen, e sponsorizuar nga Komiteti Ekonomik per Evropën i Kombeve te Bashkuara (Berlin, Shtator 2002); Konferenca mbi Dialogun Social mbi Plakjen per Vendet qe po

²¹ Gjithsesi, plakja e emigranteve duhet marre gjithashtu ne konsiderate.

Hyjne ne BE, e sponsorizuar nga ILO dhe qeverite Gjermane e Japoneze (Budapest, Nentor 2002), dhe Konferenca Nenrajonale mbi Ristrukturimin e Skemave te Pensioneve te Invaliditetit, e sponsorizuar nga ILO dhe qeveria Çeke (Prague, Dhjetor 2002).

Duke marre ne konsiderate keto dhe te tjera alternativa politike, per qeverite eshte e nevojshme te zgjerojne perfshirjen ne procesin e politikës sociale te partnereve sociale si dhe te gjithë subjekteve te interesuara ne te ardhmen e sistemit te pensioneve. Vetem permes dialogut social te hapur çdo vend mund te gjeje zgjidhjet e drejta politike dhe burimet ne kuadrin e prioriteteve te politikave te tij te gjithanshme. Vetem ky kendveshtrim mund t'u siguroje reformave fleksibilitetin, legjitimitetin dhe mbështetjen publike qe ato kerkojne per te qene te qendrueshme dhe te suksesshme.

Ne disa vende, perpjekje te tilla do te duhet te gjenin nje ekuilibër te ri midis qellimeve per qendrueshmerine ekonomike dhe nivelit te kenaqshem te perfitimeve sociale. Sikurse duket, ky ekuilibër ne disa vende gjate viteve 1990 ka anuar shume ne drejtim te qendrueshmerise ekonomike, duke sjelle si rezultat qe sistemet e pensioneve rrezikonin ne nje mase te konsiderueshme per t'i lene personat e punesuar ne gjendjen e varferise gjate pleqerise se tyre. Kjo sprapsje nga ndarja e riskut eshte pershtatur veçanerisht keq ne kushtet e ekonomise se tregut ne Evropën Qendrore, ku personat e punesuar jane te ekspozuar ndaj shume risqeve te reja dhe prandaj kane nje nevojë me te madhe per marreveshje kolektive per mbrojtjen e tyre.

Koha ka kaluar me debate dhe me zgjidhjen e papershtatshme per çështjen e plakjes se popullsisë. Por akoma te gjitha çështjet e mesiperme jane mundesi reale per t'ju drejtuar sfidave demografike te pesedhete viteve te ardhshme, sfidave qe kane qene ne qender te vemendjes se debate. Keto mudesi do te kerkojne dhe terheqin nje vemendje me te madhe nga qeverite dhe partneret e tyre sociale ne vitet qe do te vijne.

REFERENCA

Augusztinovics, M.; Gal, R.; Matits, A.; Mate, L.; Simonovits, A.; Stahl, J.: "The Hungarian Pension System Before and After the 1998 Reform". in: Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe. Volume 1*. International Labour Office: Budapest, 2002.

Barr, Nicholas: "Reforming Pensions: Myths, Truths, and Policy Choices." IMF Working Paper WP/00/139, Washington, DC: IMF, 2000.

Baker, D.; Weisbrot, M.: "The Role of Social Security Privatization in Argentina's Economic Crisis." Washington, DC: Center for Economic and Policy Research, 2002.

Beattie, R.; McGillivray, R.: "Risky Strategy : Reflections on the World Bank Report Averting the Old Age Crisis. ". *International Social Security Review Vol. 48*. Geneva, 1995.

Ciao K. Koch-Weser: "Pension Reform in Central and Eastern European Countries." The World Bank: Washington DC, 1997.

Cichon, M.; Hagemeyer, K.; Scholz, W.: "Social Budgeting in Transition Economies." *International Social Security Review Vol. 54*. Geneva, 1999.

Cichon, M.; Hagemeyer, K.; Ruck, M.: "Social Protection and Pension Systems in Central and Eastern Europe." ILO CEET: Budapest, 1998.

Cichon, Michael (ed.): "Social Protection in the Visegrad Countries: Four Country Profiles." ILO CEET: Budapest, 1995.

Chłoń-Domińczak, Agnieszka: "The Polish Pension Reform of 1999." in: Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe. Volume 1*. International Labour Office: Budapest, 2002.

Economic Commission for Europe: *Economic Survey of Europe*. 1999/3. Geneva, 1999.

Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe: Volume 1, Restructuring with Privatization: Case Studies of Hungary and Poland*. ILO CEET: Budapest, 2002.

Fultz, Elaine (ed): *Pension Reform in Central and Eastern Europe: Volume 2, Restructuring Public Pension Schemes: Case Studies of the Czech Republic and Slovenia*. ILO CEET: Budapest, 2002.

Fultz, Elaine and Ruck, Markus, "Pension reform in Central and Eastern Europe: An Update on the Restructuring of National Pension Schemes in Selected Countries," ILO CEET: Budapest, 2000.

Fultz, Elaine and Ruck, Markus (eds.): *Reforming Worker Protections: Disability Pensions in Transformation*. ILO CEET: Budapest, 2002.

Fultz, Elaine; Ruck, Markus; and Steinhilber, Silke: *The Gender Dimensions of Social Security Reform in Central and Eastern Europe: Case Studies of Hungary, the Czech Republic, and Poland*, forthcoming publication, ILO CEET: Budapest, 2003.

Gal, R.; Simonovits, A.; Tarcali, G.: "Generational Accounting and Hungarian Pension Reform." Social Protection Discussion paper No. 0127. The World Bank: Washington DC, 2001.

Gillion, C.; Bonilla, A.: "Analysis of a national private pension scheme: the case of Chile." *International Labour Review Vol. 131*. Geneva, 1992.

Gillion, C.; Turner, J.; Bailey, C.; Latulippe, D.: *Social Security Pensions. Development and Reform*. International Labour Office: Geneva, 2000.

Holzmann, R.; Orenstein, M.; Rutkewski, M.: "Pension Reform in Europe: Process and Progress." The World Bank: Washington DC, 2000.

International Labour Office, "Actuarial valuation of the pension scheme operated by the Human Resource Development Authority of Cyprus as of 31 December 2000. A Technical Note." Geneva, 2001.

International Labour Office. "Republic of Cyprus." Report to the Government Actuarial valuation of the Social Insurance Scheme as of 1 July 1997. Geneva, 1997.

International Labour Office. *Social Security: A new consensus*. Geneva, 2001.

International Labour Office. "World Labour Report 2000." Geneva, 2000.

Macha, Martin: "The Political Economy of Pension Reform in the Czech Republic." in: Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe. Volume 2*. International Labour Office – Budapest, 2002.

McGillivray, W.R. and Karasyov, D.: "Note on social security pension scheme systems of contributions collection." International Social Security Association. Geneva, 2001.

Müller, Katharina: „Between State and Market: Czech and Slovene Pension Reform in Comparison." in: Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe. Volume 2*. International Labour Office: Budapest, 2002.

Müller, Katharina: "Pension Reform in the East European Accession Countries," manuscript in draft, 2003.

Müller, Katharina: *The Political Economy of Pension Reform in Central-Eastern Europe*. Edward Elgar Publishing: Northampton MA, 1999.

Müller, Katharina: *Privatising Old-Age Security: Latin America and Eastern Europe Compared*. Frankfurt Institute for Transformation Studies. Frankfurt (Oder), 2002.

Müller, K.; Ryll, A.; Wagener, H.J.: *Transformation of Social Security: Pensions in Central-Eastern Europe*. Physica-Verlag. Frankfurt (Oder), 1999.

Orszag, Peter R. and Stiglitz, Joseph E.: “Rethinking Pension Reform: Ten Myths About Social Security Systems.” Presented at the conference on New Ideas about Old Age Security. The World Bank: Washington DC, 1999.

“Pre-Accession Economic Programme 2002 – Republic of Turkey.”

Queisser, Monika: “Towards more individual choice in social protection?” International Social Security Association – European Regional Meeting, 1999.

Sarfati, H.; Bonoli, G. (eds.): *Labour Market and Social Protection Reforms in International Perspective*. International Social Security Association: Ashgate Publishing, 2002.

Samuel, Lenia: “Cyprus.” *The Challenge of Tripartism in Social Governance*. ILO CEET: Budapest, 1994.

Schmähl, W.; Horstmann, S. (eds.): *Transformation of Pension Systems in Central Europe*. Edward Elgar Publishing. Northampton MA, 2002

“Social Protection Systems in the 13 Candidate Countries.” European Commission. http://europa.eu.int/comm/employment_social/soc-prot/social/index_en.htm

International Social Security Association. *Social Security Financing: Issues and Perspectives*. Geneva, 1996.

Standing, Guy: “Globalisation and Flexibility: Dancing Around Pensions.” International Labour Office: Geneva, 2000.

Stanovnik, Tine: “The Political Economy of Pension Reform in Slovenia.” in: Fultz, Elaine (ed.): *Pension Reform in Central and Eastern Europe. Volume 2*. International Labour Office: Budapest, 2002.

Stanovnik, Tine: “Social Security in European Countries in Transition: Are There Lessons to Be Learned?” a paper prepared for the ILO Employment Forum, Beijing, 2003.

Thompson, Lawrence: “*Adjusting Pensions for Social and Demographic Changes: The Need for Truth in Packaging.*” a paper prepared for the Conference of the European Institute of Social Security, Sweden, 2000.

Thompson, Lawrence: *Older and Wiser: The Economics of Public Pensions.* The Urban Institute Press: Washington DC, 1998.

The World Bank: *Averting the Old Age Crisis.* Washington DC, 1994.

The World Bank: “Participation in Policy Formulation and Implementation: Pension Reform in Poland” *Participation in Macroeconomics. Case studies.* Washington DC, 2000.